



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

Kontrolli i Lartë i Shtetit

# RAPORT MONITORIMI VITI 2024

## Plani Strategjik 2023-2027



Përgatitur nga Departamenti i Metodologjisë, Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit  
Profesional

# PËRMBAJTJA

01

**Hyrje**

02

**Rëndësia e monitorimit të objektivave**

03

**Qëllimi 1**

Rritja dhe përmirësimi i rolit të KLSH si mbështetës i Kuvendit për llogaridhënie efektive dhe shqyrtim të kujdesshëm e të thelluar të enteve përdoruese të fondeve publike

04

**Qëllimi 2**

Rritja e impaktit të punës audituese në qeverisjen e mirë nëpërmjet përmirësimit të nivelit të zbatimit të rekomandimeve

05

**Qëllimi 3**

Optimizimi i kapaciteteve profesionale me qëllim zotërimin e njohurive inovative në punën audituese

06

**Objektivat e perealizuara**

07

**Anekse**

## HYRJE

Kontrolli i Lartë i Shtetit është institucion i pavarur, kushtetues, i cili nëpërmjet ekspertizës dhe auditimeve cilësore, mbështet Kuvendin dhe informon publikun dhe palët e interesit në mënyrë të vazhdueshme, të paanshme dhe të plotë mbi përgjegjshmërinë që qeveria dhe entet publike tregojnë në menaxhimin e parasë së taksapaguesve, me qëllim përmirësimin e shërbimeve publike.

Strategjia e Zhvillimit të KLSH - së 2023-2027, si dokumenti strategjik më i rëndësishëm, i cili në linjë me misionin, e udhëheq Kontrollin e Lartë të Shtetit në aktivitetin e tij institucional, duke ju përshtatur dhe përgjigjur në kohë dhe me përgjegjshmëri dinamikave dhe zhvillimeve lokale dhe globale, - ka përfunduar tashmë vitin e dytë të zbatimit të tij.

Edhe gjatë vitit 2024, zbatimi i Strategjisë është zberthyer në nën objektiva dhe aktivitete, nëpërmjet të cilave institucioni ka synuar rritjen e cilësisë së auditimeve, duke iu përgjigjur në mënyrë të vazhdueshme dinamikave, në veçanti sa i takon: ndërtimit të një sistemi efektiv të menaxhimit të cilësisë së auditimit plotësisht në përputhje me ISSAI 140; konsolidimit të praktikave të planifikimit vjetor dhe operacional sipas metodologjive të përditësuara; konsolidimit të mëtejshëm të marrëdhënieve me Kuvendin dhe Nën Komisionin Parlamentar

për Auditimin e Sektorit Publik nëpërmjet dëgjësave parlamentare dhe raportimeve të vazhdueshme; përdorimit të vizualizimeve për të përmirësuar efikasitetin e përcjelljes së punës audituese; si dhe komunikimit të rezultateve të auditimeve dhe veprimtarisë së KLSH nëpërmjet mediave sociale, prezencës në shtypin e shkruar dhe atë audio – viziv, si dhe nëpërmjet broshurave, buletineve dhe aktiviteteve

Me qëllim përmbushjen e objektivave strategjike, nën objektivave dhe aktiviteteve përkatëse, KLSH ka hartuar planin e veprimit për implementimin e strategjisë, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 144, datë 01.08.2023, i cili ka vijuar të zbatohet edhe përgjatë vitit 2024. Ky plan është monitoruar në mënyrë sistematike për vlerësimin e nivelit të arritjes së objektivave kundrejt parashikimit. Monitorimi i kësaj strategjie, ka kërkuar nga ana e KLSH – së angazhimin e vazhdueshëm të të gjitha strukturave të institucionit në drejtim të realizimit të aktiviteteve specifike të planit të veprimit dhe raportimin mbi rezultatet e arritura nga ky zbatim.

Për këtë arsye, ky raport monitorimi synon të identifikojë dhe vlerësojë statusin e zbatueshmërisë së objektivave strategjike sipas planit të veprimit për vitin 2024, njësitë përgjegjëse për secilin objektiv dhe veprimet e ndërmarra nga to për realizimin e objektivave përkatëse, si dhe afatin e përmbushjes së tyre.



# RËNDËSIA E MONITORIMIT TË QËLLIMEVE & OBJEKTIVAVE STRATEGJIKE

“ KLSH është një institucion model që udhëheq nëpërmjet shembullit, që nxit rritjen e përgjegjshmërisë, transparencës, dhe përmirësimin e shërbimeve publike, nëpërmjet auditimeve cilësore dhe luftës kundër korrupsionit, duke forcuar integritetin dhe besimin e publikut tek institucioni.



Në përmbushje të misionit dhe vizionit të tij, KLSH ka përcaktuar tre qëllime strategjike që udhëheqin punën e institucionit, realizimi i të cilëve është kritik dhe monitorohet periodikisht.

## Qëllimi Strategjik 1


Rritja dhe përmirësimi i rolit të KLSH si mbështetës i Kuvendit për llogaridhënie efektive dhe shqyrtim të kujdesshëm e të thelluar të enteve përdoruese të fondeve publike.

## Qëllimi Strategjik 2

Rritja e impaktit të punës audituese në qeverisjen e mirë, nëpërmjet përmirësimit të nivelit të zbatimit të rekomandimeve.

## Qëllimi Strategjik 3


Optimizimi i kapaciteteve profesionale me qëllim zotërimin e njohurive inovative në punën audituese.



Gjatë vitit 2024, rezulton se janë realizuar 95% e objektivave të përcaktuara ( të detajuar më tej në Tregues Performance).

Monitorimi i vazhdueshëm i arritjes së qëllimeve dhe objektivave strategjike, është i rëndësishëm pasi na siguron:

- ✓ Përafrim me misionin dhe qëllimet
- ✓ Përmirësim të vazhdueshëm
- ✓ Përshtatshmëri ndaj dinamikave
- ✓ Shfrytëzim efektiv të burimeve



**Infografik:** Objektivat e realizuara, viti 2024 (%)

# QËLLIMI 1



## **RRITJA DHE PËRMIRËSIMI I ROLIT TË KLSH SI MBËSHTETËS I KUVENDIT PËR LLOGARIDHËNIE EFËKTIVE DHE SHQYRTIM TË KUJDESSHËM E TË THELLUAR TË ENTEVE PËRDORUESE TË FONDEVE PUBLIKE**

KLSH dhe Kuvendi, si dy nga komponentët kryesorë të sistemit të llogaridhënies, kanë role reciprokisht mbështetëse për të siguruar një qeverisje efektive. Si partnerë kryesorë në promovimin e qeverisjes së mirë, të dy institucionet luajnë një rol kyç në strukturën e qeverisjes së vendit tonë. Kuvendi mund të kryejë funksionet e tij jetike të mbikëqyrjes së aktivitetit qeveritar në mënyrë më efektive dhe efikase, kur ai përdor dhe mbështetet në punën audituese të KLSH-së. Auditimet e kryera nga KLSH ofrojnë një bazë të fortë dhe të besueshme për Kuvendin për të mbikëqyrur veprimtarinë ekzekutive dhe për të ndërmarrë masa korrigjuese ku është e nevojshme. Nga ana tjetër, diskutimi i raporteve të auditimit në Kuvend dhe në Nën Komisionin për Auditimin e Sektorit Publik nxit ndërgjegjësimin dhe llogaridhënien e ndërsjellët midis Kuvendit, KLSH – së dhe Ekzekutivit, nëpërmjet dialektikës së të cilëve, informohet publiku i gjerë mbi rezultatet e punës së gjithësecilit, dhe sigurohet transparencë e shtuar në lidhje me përdorimin e fondeve publike.

Edhe përgjatë vitit 2024, nëpërmjet punës audituese, KLSH ka synuar të sigurojë një rritje të rolit të tij, si institucioni suprem auditimi në mbrojtje të financave publike në vendin tonë. Duke përmirësuar performancën e vet institucionale audituese, KLSH ka dhënë kontributin e vet në përfitimin e taksapaguesve, duke rekomanduar vazhdimisht që fondet publike përdoren në mënyrë të drejtë dhe efikase, dhe duke mbështetur Kuvendin në shqyrtimin e thelluar të punës së ekzekutivit.

Ky qëllim, përmbushet nëpërmjet tre objektivave të mëposhtme:

**1.1** Kryerja e planifikimit strategjik bazuar në analizë të përditësuar risku me qëllim mbulimin efektiv me auditim dhe kryerjen e auditimeve cilësore

**1.2** Implementimi i plotë i Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe praktikave të mira gjatë të gjitha fazave të auditimit

**1.3** Komunikimi dhe bashkëpunimi i vazhdueshëm i KLSH-së me Kuvendin

# 1.1 Kryerja e planifikimit strategjik bazuar në analizë të përditësuar risku me qëllim mbulimin efektiv me auditim dhe kryerjen e auditimeve cilësore



1


## Metodologjia e Planifikimit Vjetor të Auditimeve

Me miratimin e Metodologjisë së Planifikimit Vjetor të Auditimeve, me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 166, datë 26.09.2023, për vitin 2024 procesi i planifikimit vjetor të auditimeve është kryer nga të gjithë departamentet e auditimit në mënyrë të unifikuar sipas indikatorëve dhe hapave të paraqitura në të. Në auditimet e performancës, Departamenti përkatës ka ndërthurur përgatitjen e temave të auditimit për Planin Vjetor të Auditimeve nëpërmjet Metodologjisë së Planifikimit Vjetor të Auditimeve, Manualit të Auditimit të Performancës dhe Udhëzuesit të Fushave me Risk, si një pjesë tashmë e konsoliduar e metodologjisë së ndjekur nga ky departament. Këto dokumente vijojnë të ruajnë relevancën e tyre në drejtim të parimeve që duhen ndjekur në fazat thelbësore të hartimit të Planit Vjetor të Auditimeve.

2

## Përzgjedhja e auditimeve mbi bazë risku

Në kuadër të hartimit të planit vjetor të auditimeve për vitin 2024, të gjitha departamentet e auditimit kanë zhvilluar workshope, ku audituesit kanë propozuar tema auditimi, dhe më pas vlerësimi e përzgjedhja e tyre është bërë duke përdorur metodologjinë e mësipërme. Departamenti i Auditimit të Performancës, vlerësimin dhe përzgjedhjen e temave të auditimit e ka kryer bazuar gjithashtu në Udhëzuesin e Fushave me Risk. Përgjatë këtyre aktiviteteve kanë qenë të ftuar edhe përfaqësues nga grupe të ndryshme të interesit si: Kuvendi i Shqipërisë, fusha akademike, etj.



### 3

## Monitorimi i planit të auditimeve

Plani vjetor i auditimeve për vitin 2024, është miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH – së nr. 210, datë 18.12.2023, ku parashikohet realizimi i 155 auditimeve. Gjatë vitit 2024, KLSH ka evaduar 159 auditime, nga 155 auditime të planifikuara, duke tejkaluar planin vjetor të auditimeve në masën 2.6%.



### 4

## Mbulimi me auditime i fushave të OZHQ

Në përmbushje të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) sipas Axhendës 2030, nëpërmjet punës audituese, në përputhje edhe me prioritetet strategjike të INTOSAI-t, gjatë vitit 2024, Departamenti i Performancës ka kryer 7 auditime (ose 4 auditime më shumë se viti 2023), që mbulojnë fushat e OZHQ-ve, si :


- ✓ Për OZHQ3 “Shëndet dhe Mirëqenie” temat: “Politikat dhe respektimi i të drejtave të personave me probleme të shëndetit mendor në shërbimin spitalor Psikiatrik”; “Efektiviteti i pajisjeve mjekësore në sistemin spitalor publik”; “Efektiviteti dhe siguria e barnave që qarkullojnë në Shqipëri”, dhe “Procesi i birësimit të fëmijëve dhe garantimi i të drejtave të tyre për mirëritje dhe edukim”.

Për OZHQ4 “Arsim Cilësor”, tema: “Orientimi për Karrierë i të Rinjve në Sistemin Arsimesor Parauniversitar”.

- ✓ Për OZHQ13 “Veprim për klimën”, tema: “Zbatimi i Planit Kombëtar për Zbutjen dhe Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike”.
- ✓ Për OZHQ15 “Jeta në tokë”, tema: “Ndikimi i aktivitetit minerar në fondin pyjor”.



# 1.2 Implementimi i plotë i Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe praktikave të mira gjatë të gjitha fazave të auditimit




## 1

### Adoptimi dhe përditësimi i udhëzuesve/manualeve

Me qëllim sigurimin e vazhdimësisë, profesionalizmit, dhe cilësisë së zbatimit të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, janë adoptuar dhe përditësuar vazhdimisht udhëzuesit dhe manualët duke iu përgjigjur në kohë ndryshimeve. Gjatë vitit 2024, për shkak të rishikimit të ISSAI 140 “Menaxhimi i Cilësisë për Institucione Supreme të Auditimit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka hartuar dhe miratuar dokumentet kryesore që në do të rregullojnë menaxhimin e cilësisë në KLSH në vijim, në përputhje me ISSAI 140 që janë: “Politika e Menaxhimit të Cilësisë në KLSH”, “Udhëzuesi i Menaxhimit të Riskut të Cilësisë”, “Regjistri i Riskut të Cilësisë”, Procesi i hartimit të këtyre dokumentave është kryer nën mbikëqyrjen e vazhdueshme të IDI-t, në kuadër të projektit pilot për Implementimin e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë së Auditimit. Kalimi nga koncepti i kontrollit të cilësisë në menaxhim të cilësisë, orienton KLSH – në drejt një qasje holistike në këtë drejtim, sikundër parashikohet edhe nga standardi i rishikuar.

### Zbatimi i praktikave më të mira - Manuali i auditimit të koncesioneve dhe partneriteteve private publike

Në kuadër të projektit “Forcimi i kapaciteteve profesionale të Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH) në auditimin e Kontratave Koncesionare dhe të Partneritetit Privat Publik në Shqipëri”, financuar nga Sekretariati për Çështje Ekonomike të Zvicrës (SECO), është hartuar dhe miratuar Manuali për auditimin e koncesioneve dhe partneriteteve private publike (PPP)”, me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 231, Datë 12.12.2024. Projekti mbështeti KLSH - në për të përmirësuar ekspertizën profesionale në kryerjen e auditimeve të kontratave koncesionare, duke mbështetur kështu rritjen e kapaciteteve të KLSH - së në kryerjen e auditimeve të kontratave koncesionare/PPP-ve dhe produktet kryesore të tij janë asistencë për realizimin e tre auditimeve pilot të kontratave koncesionare/PPP-ve, manuali për auditimin e kontratave koncesionare dhe të PPP-ve dhe trajnimi i personelit për kuptimin dhe zbatimin e manualit në procesin e auditimit.



### 3

## Orientimi drejt auditimeve të sistemit

Auditimet mbi bazë sistemi kanë vijuar të jenë në fokusin e veprimtarisë së KLSH – së. Duke ndjekur praktikat e mira në këtë fushën si dhe dinamikat makroekonomike të diktuar nga evoluimi i shpejtë i teknologjisë, bazuar edhe në rekomandimet e Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë, edhe gjatë vitit 2024, është synuar orientimi drejt auditimeve të sistemeve me qëllim parandalimin e fenomeneve që kanë impakt negativ në financat publike. Gjatë vitit 2024, janë kryer 3 auditime mbi bazë sistemi, konkretisht:

01

Ecuria e detyrimeve shtetërore për Vendime të formës së prerë të GJEDNJ dhe Arbitrazhit Ndërkombëtar si dhe vlerat e ekspozimit të Buxhetit të Shtetit nga çështjet në proces gjykimi

02

Mbi detyrimet e ndërsjellëta” në KESH sh.a., OST sh.a. dhe OSHEE sh.a

03

Procesi i Birësimit të fëmijëve dhe garantimi i të drejtave të tyre për mirërritje dhe edukim.

### 4

## Modernizimi logjistik

Përgjatë vitit 2024, Departamenti i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit, në KLSH ka vijuar bashkëpunimin me ekspertët e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të Norvegjisë (OANG) në drejtim të përmirësimit të cilësisë së auditimeve me anë të zhvillimit të workshop -eve online dhe on - site si dhe webinarë - ve, duke u fokusuar në Sigurinë e Informacionit dhe Sigurinë Kibernetike. Gjatë kësaj periudhe, audituesit e KLSH-së janë njohur dhe trajnuar për përdorimin e disa mjeteve IT (Open Source) në të cilat OANG bazohet për Auditimet e Teknologjisë së Informacionit, veçanërisht me fokus Sigurinë Kibernetike. Për implementimin e njohurive dhe teknikave të marra gjatë trajnimeve, ka nisur një auditim pilot me temë “Siguria kibernetike ne infrastrukturën kritike,

në e-Taxation”, në bashkëpunim me ekspertët IT të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të Norvegjisë . Gjithashtu, gjatë vitit 2024, nisi procesi i migrimit të të dhënave në Outlook-in e ri, i cili synon të përfshijë kalimin e informacionit në një platformë më të sofistikuar, duke mundësuar ndër të tjera, përdorimin e "shared docs" përmes OneDrive, e duke përmirësuar bashkëpunimin dhe aksesin në dokumente në kohë reale.



## 5

## Bashkëpunimi me SAI-et homologe, me EUROSAI/ INTOSAI-n dhe institucione ndërkombëtare

Gjatë vitit 2024, KLSH ka vijuar bashkëpunimin me SAI homologe EUROSAI/ INTOSAI – n dhe institucione ndërkombëtare ku përmendim:

### EUROSAI

- Konferenca VI Young EUROSAI (YES)
- Kongresi XII EUROSAI/SAI i Izraelit
- Sesioni i pranverës i Grupit të Punës të EUROSAI-t për Auditimet e Mjedisit (ëGEA) me temë kryesore “Çështjet e Sigurisë së Energjisë”
- Takimi X i Grupit të Punës të EUROSAI-t për Auditimin e Fondeve të Alokua për Fatkeqësitë dhe Katastrofat (WGAFADC)
- Takimi 8 vjetor i EUROSAI/WGMA mbi “Projektet e infrastrukturës së qeverisjes lokale”
- Takimi i 17-të të Grupit të Punës IT të EUROSAI (ITWG) me temë kryesore “Auditori inteligjent në një shtet inteligjent artificial (të auditosh IA)”
- ëorkshop-i mbi Krimet Mjedisore organizuar nga Agjencia Evropiane e Hapësirës në bashkëpunim me EUROSAI/ ëGE
- Masterklasi online i EUROSAI/TFMA mbi aspektet metodologjike të auditimit “Të ardhurat e bashkive për shërbime cilësore ndaj qytetarëve;
- etj

### INTOSAI / IDI

- Trajnimi ndërkombëtar online i SAI-t të Indisë / INTOSAI/WGEA/WGEI mbi “Mbi industrinë nxjerrëse”
- KLSH merr pjesë në auditimin global IDI/INTOSAI WGEA me temë “Zbatimi i Planit Kombëtar për zbutjen dhe përshatjen ndaj ndryshimeve klimatike
- webinar-i SAI I Indisë / INTOSAI ITWG mbi “Përdorimin e analizës gjeohapsinore në auditim”;
- Simpoziumi 26 UN/INTOSAI “Zbatimi i SDG-ve mbi klimën: roli, kontributi dhe eksperiencia e SAI-ve”
- Programi pilot për ISSAI 140 - Menaxhimi i Cilësisë së Auditimit
- Programi PESA - P për kualifikimin e audituesve
- etj

### Vizita zyrtare

- Vizita studimore pranë NAO të Anglisë
- Vizita studimore pranë Gjykatës Turke të Llogarive
- Vizitë pune në ZKA Kosovë
- Takimi vjetor i IBAN/NATO
- Konferenca “Mbi auditimin e llogarive përfundimtare të buxhetit të shtetit
- Konferenca “Mbi shpenzimet publike”, organizuar nga Banka Botërore
- Simpoziumi ndërkombëtar “Trajektorja e re në luftën kundër korrupsionit
- Takimi ndërkombëtar i audituesve “Bashkëpunimi mes SAI-ve dhe autoriteteve të Auditimit të Brendshëm”
- Konferenca online mbi “Auditimin e financimit të partive politike dhe fushatave elektorale
- etj

Gjithashtu, në kuadër të bashkëpunimit me institucionet homologe: janë zhvilluar disa auditime paralele; ka vijuar bashkëpunimi me SAI-n e Suedisë; si dhe janë zhvilluar takime, workshope e konferenca me partnerë të rëndësishëm.

### Auditime paralele ose të udhëhequra nga SAI-e homologe

- Auditimi i përbashkët “Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave në zonat rurale përmes përfshirjes në tregun e punës” në bashkëpunim me ZKA të Kosovës dhe SAI-n e Maqedonisë së Veriut dhe i organizuar nga UN Women
- Auditimi pilot mbi sistemin e-Taxation, udhëhequr nga SAI i Suedisë
- Auditimet me tema: “Cilësia e ujërave në plazhe”; dhe “Shërbimi Psiko-Social në sistemin arsimor para-universitar”, udhëhequr nga SAI i Norvegjisë

### Marrëveshje bashkëpunimi

- Rinovimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit me SAI-n e Norvegjisë për një periudhë 5-vjeçare
- Marrëveshja e Bashkëpunimit me Gjykatën e Llogarive të Turqisë.

Këto marrëveshje mbulojnë bashkëpunimin në fusha të përbashkëta me interes si mjedisi, performanca, hidrorcarburet, IT, etj dhe pasohen nga plane konkrete pune mbi zhvillimin e aktiviteteve

### Të tjera

- U përmbyll me sukses programi i trajnimit për Auditimin e Performancës (6 blloqe) organizuar nga ky institucion për audituesit e rinj të performancës të SAI-ve të Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë. KLSH mori pjesë në këtë program me 3 auditues të rinj me auditimin “Shërbimi i Policisë në Përgjigje të Qytetarëve”.
- webinar - i SIGMA-s mbi Etikën dhe Profesionalizmin
- Kursi “Bashkëpunimi mes audituesve dhe kontabilistëve në luftën kundër mashtrimit dhe korrupsionit”;
- workshop - e të zhvilluara në kuadër të auditimeve IT me fokus në tematikat e “Sigurisë së Informacionit” dhe “Qeverisjen e IT - së
- Simpoziumi 26 UN/INTOSAI “Zbatimi i SDG-ve mbi klimën: roli, kontributi dhe eksperiencia e SAI-ve”; etj.

Gjatë vitit 2024, KLSH ka intensifikuar bashkëpunimin me partnerët e tij të brendshëm dhe ndërkombëtarë, duke ndjekur praktikat më të mira në fushën e auditimit. Ky angazhim ka synuar fuqizimin e mëtejshëm të kapaciteteve profesionale të institucionit, përmes shkëmbimit të eksperiencave, për të përmirësuar vazhdimisht performancën e tij, si dhe të sigurojë një përshtatje optimale me zhvillimet dhe sfidat e mjedisit ku operon

Gjatë vitit 2024, KLSH ka rinovuar marrëveshjen e bashkëpunimit me SAI-n e Norvegjisë, për një periudhë 5 vjecare tashmë, në fushat e IT dhe të auditimit të performancës, por edhe në fushën e komunikimit dhe të procedurave të auditimit në industrinë nxjerrëse. Gjithashtu është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit me SAI-n e Turqisë, me fokus sigurinë, IT, dhe analizën e të dhënave.

Kanë vijuar aktivitetet në formën e seminareve, internship-eve, trajnimeve, si dhe bashkëpunime të ndryshme me Zyrën e Llogaridhënies së Qeverisë së SHBA-ve (GAO), Gjykatën Evropiane e Audituesve (ECA), Zyrën Kombëtare të Auditimit të Anglisë, SAI-n e Polonisë, SAI-n e Kosovës, SAI-n e Maqedonisë së Veriut, Iniciativa për Zhvillim e INTOSAI (IDI), SIGMA, SECO, etj

KLSH ka vijuar aktivitetet në kuadër të grupeve të punëve dhe Task Force-ave të EUROSAT-t, për: Auditimet e Mjedisit; Teknologjisë së Informacionit; Auditimet e Bashkive; Auditimin e Fondeve të Alokua në raste Fatkeqësish dhe Katastrofash etj.

Me qëllim shkëmbimin e eksperiencave më të mira dhe praktikave audituese, KLSH përgjatë vitit 2024 ka vijuar angazhimin në 3 auditime paralele, si vijon:

- “Planet gjithëpërfshirëse të qeverisë dhe aspektet buxhetore për një popullsi në moshim”, i cili është një auditim paralel me disa SAI-e dhe udhëhiqet nga SAI i Izraelit;
- “Barazia gjinore dhe fuqizimi i gruas nga zonat rurale përmes përfshirjes së tyre në tregun e punës” në partneritet me ZKA të Kosovës dhe SAI-n e Maqedonisë së Veriut, si dhe në bashkëpunim me organizatën UN Women; dhe
- ”Zbatimi i Planit Kombëtar për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike”, ideuar nga IDI dhe INTOSAI WGEA.

Një ndër partnerët kryesorë të KLSH-së vijon të mbetet Iniciativa për Zhvillim (IDI) e INTOSAI-t (IDI) . Edhe gjatë vitit 2024, IDI ka vijuar të asistojë në ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe njerëzore të audituesve në KLSH-së, nëpërmjet trajnimeve të ndryshme, përfshirjes në grupe pune të ndryshme si ai mbi rishikimin e ISSAI 140, ai mbi mbi sigurinë e informacionit, kurse të ndryshme profesionale si PESA, e të tjera forma edukimi për zhvillimin e vazhdueshëm të kapaciteteve audituese.

Viti 2024 shënoi përfundimin me sukses të projektit “Forcimi i Mbikëqyrjes së Auditimit të Jashtëm për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat (PPP) në Shqipëri” me Sekretariatit Shtetëror të Zvicrës për Çështjet Ekonomike (SECO), nëpërmjet të cilit: u realizuan 3 auditime pilot në fushën e koncesioneve dhe PPP-ve; u hartua Manuali për Auditimin e Koncesioneve dhe PPP-ve; si dhe u zhvillua një vizitë studimore në SAI-n e Turqisë, me qëllim shkëmbimin e eksperiencës në fushën e koncesioneve dhe PPP-ve.

## 1.3 Komunikimi dhe bashkëpunimi i vazhdueshëm i KLSH-së me Kuvendin

1

### Dëgjesat e zhvilluara dhe raportet e auditimit të përcjella në Kuvend

KLSH ka vijuar të intensifikojë komunikimin dhe bashkëpunimin me Kuvendin, duke përcjellë vazhdimisht raporte auditimi në Kuvend. Gjatë vitit 2024, KLSH ka përcjellë në Kuvend, 139 raporte auditimi.

Gjithashtu, Kuvendi është informuar periodikisht për rezultatet e punës audituese edhe nëpërmjet përcjelljes së buletineve statistikore periodike, raporteve të zbatimit të rekomandimeve, raportit mbi zbatimin e buxhetit të shtetit dhe raportit vjetor mbi aktivitetin e KLSH-së. Me krijimin e Nën Komisionit Parlamentar për Auditimin e Sektorit Publik, më datë 12.11.2024, u zhvillua mbledhja e parë e këtij nën komisioni me rend dite: “Diskutimin e projektbuxhetit të KLSH - së për vitin 2025”; si dhe dëgjesë mbi raportin e auditimit të performancës me temë “Kujdesi ndaj të moshuarve”.



### KLSH dhe Kuvendi



Gjatë vitit 2024, janë zhvilluar një sërë aktivitete të përbashkëta me objekt, intensifikimin e bashkëpunimit midis Kuvendit dhe KLSH, ku ka patur përfaqësim nga dy institucionet.

Marrëdhënia e KLSH-së me Kuvendin ka vijuar të intensifikohet edhe përgjatë vitit 2024 duke u konsoliduar më tej me krijimin e Nën – Komisionit Parlamentar për Auditimin e Sektorit Publik. Janë zhvilluar një sërë takimesh si takimi me përfaqësues dhe ekspertë të Institutit Kombëtar Demokratik (NDI) në kuadër të mbështetjes që NDI ka ofruar për Kuvendin të Shqipërisë me qëllim krijimin e nënkomisionit parlamentar; takime i organizuar nga Kryetarja e Kuvendit të Shqipërisë, me drejtuesit e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të krijuara me ligj, i cili kishte në fokus të diskutimeve raportimin dhe monitorimin sistematik të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të këtyre institucioneve.

Gjithashtu, KLSH ka marrë pjesë në aktivitetet si vijon:

- Tryezë diskutimi me temë “Rritja e përgjegjshmërisë së Parlamentit ndaj shqetësimeve të qytetarëve”, me ftesë të Institutit Shqiptar të Shkencës (AIS),
- Tryezë diskutimi “Mbi standardet dhe praktikat e procesit raportues në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë”, organizuar nga Instituti i Studimeve Politike
- Përfaqësues të KLSH-së dhe anëtarët e Nënkomisionit për Auditimin në Sektorin Publik në Kuvendin e Shqipërisë, kanë marrë pjesë në takimin e punës, iniciuar nga National Democratic Institute (NDI) mbi intensifikimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit midis Nënkomisionit të Auditimit të Sektorit Publik në Kuvendin e Shqipërisë dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit;
- Takim i organizuar nga National Democratic Institute (NDI) mbi intensifikimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit midis Parlamentit dhe SAI-t, me KLSH dhe anëtarë të Nënkomisionit për Auditimin në Sektorin Publik, mbi intensifikimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit midis Parlamentit dhe SAI-t.
- Takim me Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit (ZKA).
- Workshop mbi promovimin e “Parlamentit të hapur” në Shqipëri, ku u diskutua situata aktuale dhe plani për përmirësi




## 2

### Raportet e zbatimit të rekomandimeve

KLSH i ka përcjellë Kuvendit të Shqipërisë dhe Ministrinë të Shtetit për Marrëdhënien me Parlamentin, 3 raporte përmbledhëse:

- “Raportin përmbledhës mbi zbatimin e rekomandimeve të auditimeve të përfunduara në vitin 2022” (Përcjellë nëpërmjet shkresave nr. 86 dhe 86/1 prot., datë 16.01.2024);
- “Raportin përmbledhës mbi zbatimin e rekomandimeve të auditimeve të përfunduara në vitin 2022, pjesa II” (Përcjellë nëpërmjet shkresave nr. 165 dhe 165/1 prot., datë 29.01.2024); dhe
- “Raportin përmbledhës mbi zbatimin e rekomandimeve të auditimeve të përfunduara në vitin 2023” (Përcjellë nëpërmjet shkresave nr. 962 prot., datë 25.07.2024 dhe 962/1 prot., datë 25.07.2024)




### 3

## Plotësimi periodik i Platformës Ndërinstitucionale Online të Kuvendit mbi zbatimin e rekomandimeve

Përdorimi i Platformës Ndërinstitucionale të Kuvendit për të raportuar në kohë reale rekomandimet e lëna nga KLSH ka paraqitur disa probleme teknike. Pavarësisht kësaj, në sajë të bashkëpunimit të vazhdueshëm, edhe gjatë vitit 2024, KLSH i ka përcjellë Kuvendit informacionin për të rekomandimet (sipas kërkesave) në formë shkresore dhe elektronike.

Për të lehtësuar edhe me tej komunikimin e vazhdueshëm dhe përcjelljen më eficiente të informacioneve të kërkuara nga Kuvendi sa i takon rekomandimeve të lëna me auditimet e KLSH, është rikonceptuar formatin i statistikave të auditimeve për të mundësuar përmbledhjen, renditjen, riorganizimin, grupimin, numërimin etj, të të dhënave. Gjithashtu, është rikonceptuar formati statistikor mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme, në mënyrë që ky format të shërbejë edhe si regjistër rekomandimesh, për t'u ndjekur në kohë reale.

## QËLLIMI 2



### RRITJA E IMPAKTIT TË PUNËS AUDITUESE NË QEVERISJEN E MIRË NËPËRMJET PËRMIRËSIMIT TË NIVELIT TË ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE

KLSH, synon të rrisë impaktin e punës audituese dhe të kontribuojë në qeverisjen e mirë, nxitjen e përgjegjshmërisë, llogaridhënies dhe transparencës së përdorimit të fondeve publike, nëpërmjet dhënies së rekomandimeve praktike, të qarta dhe të orientuara drejt veprimeve konkrete, për përmirësimin e situatës së konstatuar dhe forcimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Monitorimi i nivelit të zbatimit të rekomandimeve nga entet publike të audituara, në bashkëpunim edhe me Kuvendin, me qëllim nxitjen e institucioneve publike për zbatimin e tyre, është treguesi kryesor për matjen e impaktit të punës audituese.

Ky qëllim, përmbushet nëpërmjet pesë objektivave të mëposhtme:

- 2.1** Promovimi i vazhdueshëm i rolit të KLSH-së dhe punës audituese, si garantues i mirëpërdorimit të fondeve publike, nëpërmjet përdorimit të mjeteve të komunikimit
- 2.2** Thellimi dhe shtrirja e bashkëpunimit me institucionet ligjzbatuese
- 2.3** Forcimi i pavarësisë dhe mandatit të KLSH-së
- 2.4** Hartimi i raporteve të auditimit, të kuptueshme, të qarta dhe relevante për lexuesin
- 2.5** Përdorimi i teknikave të të shkruarit profesional që përcjell informacion, gjetje dhe rekomandime në mënyrë të qartë, koncize dhe efektive

## 2.1 Promovimi i vazhdueshëm i rolit të KLSH-së dhe punës audituese, si garantues i mirëpërdorimit të fondeve publike, nëpërmjet përdorimit të mjeteve të komunikimit

KLSH ka paraqitur dhe komunikuar punën audituese duke përdorur kanalet më efektive të komunikimit për të mbërritur deri tek përdoruesi më i fundit, qytetari. Në funksion të misionit që ka, KLSH synon t'u shërbejë qytetarëve dhe taksapaguesve, duke u ofruar mundësinë dhe aksesin e plotë në informacion për të kontribuar në realizimin e qëllimit të përbashkët, që është mirëqeverisja.



### 1 Publikimi dhe promovimi i raporteve të auditimit nëpërmjet broshurave

KLSH ka publikuar në faqen [web 106](#) raporte auditimi të vitit 2024, me qëllim promovimin e punës audituese dhe informimin e vazhdueshëm të palëve të interesit. Gjithashtu, për auditimet me ndjeshmëri të lartë, ka promovuar rezultatet e auditimit nëpërmjet përgatitjes së broshurave, dhe shpërndarjen e tyre tek të gjithë të ftuarit, gjatë aktiviteteve të analizave vjetore të departamenteve të auditimit. Gjatë vitit 2024 janë përgatitur:

- Broshurë informuese mbi “Cyber Security”
- Broshura informuese mbi “Javën e Integritetit në KLSH”
- Broshurë informuese mbi auditimin e performancës “Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonat rurale, përmes përfshirjes në tregun e punës”, në bashkëpunim me zyrën UN ëomen në Shqipëri
- Buletini Informues mujor për Kuvendin
- Broshura mbi Kodin Etik



## 2

### Promovimi i raporteve të auditimit nëpërmjet organizimit të aktiviteteve



Në kuadër të promovimit të raporteve të auditimit, në bashkëpunim me Entin Shtetëror të Revizionit të Maqedonisë së Veriut, Zyrën Kombëtare të Auditimit të Kosovës dhe UN Women, KLSH realizoi auditimin e përbashkët me temë “Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonat rurale, përmes përfshirjes në tregun e punës”. Gjetjet e auditimit janë prezantuar në Tiranë më datën 6 qershor 2024 në takim të mbajtur për prezantimin e raportit të KLSH – së me përfaqësues nga UN Women dhe KLSH. Ky takim u pasua nga takimi rajonal i mbajtur në datën 17 korrik 2024 në Shkup, gjete të cilit edhe u prezantuan rezultatet e punës së SAI – ve pjesëmarrëse në këtë auditim rajonal.

Gjithashtu, në kuadër të projektit “Forcimi i Mbikëqyrjes së Auditimit të Jashtëm për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat (PPP) në Shqipëri” mes Sekretariatit Shtetëror të Zvicrës për Çështjet Ekonomike (SECO) dhe KLSH-së, u paraqitën rezultatet e auditimeve pilot, në fushën e koncesioneve dhe PPP-ve, në një takim ku morën pjesë auditues, përfaqësues të shoqërisë civile, ekspertë të jashtëm, si dhe përfaqësues të Ambasadës Zvicerane në Shqipëri dhe të Sekretariatit Shtetëror të Zvicrës, për Çështjet Ekonomike.


## 3


### Artikuj dhe kronika në median audio-vizive mbi veprimtarinë e KLSH

Gjatë vitit 2024 në shtypin e shkruar dhe në median audio - vizive janë publikuar gjithsej 1809 artikuj që trajtojnë gjetje nga raportet e auditimit të KLSH-së, nga të cilët 382 në shtypin e shkruar dhe 1448 në median audiovizive dhe online. Nga këto të fundit, 205 kanë qenë kronika dhe materiale të zgjeruara.

**Raporti i KLSH, të sëmure me leucemi pa ilaçin jetësor! Drejtuesi i hematologjisë kërkoi masa: Duhet ndryshuar protokollin e kurimit**

*Dhjetëra pacientë të cilët vuajnë nga Leucemia Limfoidike Kronike, që prej muajit shtator nuk po trajtohen me një prej medikamenteve kryesorë, bazin 'dasutinib 140 mg'. Pacientët të cilët trajtohehin prej 2 vitesh me këtë medikament nuk e marrin më si shërbim për shkak të paqarësisë në protokollin e përdorimit, nëse mjekimi duhet të vazhdojë pa afat, apo maksimumi deri në 2 vite.*





## 4

### Pasurimi i faqes së web-it

Faqja zyrtare e institucionit ka vijuar të pasurohet edhe me informacione në gjuhën angleze si njoftimet mbi takimet e Kryetarit apo bashkëpunimet me institucione të ndryshme brenda dhe jashtë vendit. Raportet vjetore të Performancës si dhe Raportet për Zbatimin e Buxhetit të Shtetit publikohen tashmë edhe në gjuhën angleze. Dokumente të tjerë si: Strategjia e Zhvillimit të KLSH, 2023 - 2027, Udhëzuesi për Menaxhimin e Riskut të Cilësisë, Politika për Sistemin e Cilësisë së Auditimit, etj standarde auditimi janë publikuar edhe në versionin anglisht.

## 5

### Administrimi i ankesave dhe kërkesave

Kontrolli i Lartë i Shtetit vijon të shqyrtojë me korrektësi dhe profesionalizëm të gjitha ankesat, denoncimet dhe kërkesat për informacion të ardhura nga qytetarët dhe media të ndryshme. Konkretisht, gjatë periudhës janar - dhjetor 2024, ka administruar 291 letra nga qytetarët dhe palët e ndryshme të interesit në formën e ankesave, kërkesave për informacion apo denoncimeve. Numri më i madh i këtyre ankesave ka marrë një përgjigje brenda afateve kohore të përcaktuara në ligj. Një pjesë e tyre mbeten në proces verifikimi në auditime të radhës sipas tematikave përkatëse, në përfundim të të cilave KLSH informon menjëherë qytetarin, ose nëse vlerësuar jashtë fushës së kompetencave të KLSH-së, i janë dërguar për kompetencë institucioneve përgjegjëse.

Gjithashtu, Koordinatorin për të Drejtën e Informimit, në cilësinë e strukturës së ngarkuar me detyrën e trajtimit të kërkesave për informacion, ka trajtuar 36 kërkesa për informacion të cilat janë përcjellë tek kërkuarit brenda afateve ligjore të përcaktuara

## 2.2 Thellimi dhe shtrirja e bashkëpunimit me institucionet ligjzbatuese

Bashkëpunimi me institucionet ligjzbatuese i shton vlerë punës audituese, duke raportuar rastet korruptive të konstatuara nga KLSH. Për këtë qëllim, KLSH ka synuar rritjen e bashkëpunimit për shkëmbimin e informacionit dhe organizimin e aktiviteteve të përbashkëta, me organet e linjës së parë në luftën kundër korrupsionit.

Gjatë vitit 2024 përfaqësues të institucionit kanë marrë pjesë në aktivitete dhe tryeza të rrumbullakëta të organizuara nga OJF me qëllim luftën kundër korrupsionit, si vijon:

- 01 Më datë 13.02.2024, KLSH merr pjesë në ditën e diskutimit publik në Shkodër, me temë: “Pjesëmarrja qytetare dhe bashkëpunimi me institucionet në luftën kundër korrupsionit”, organizuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit
- 02 Më datë 07.03.2024, KLSH merr pjesë në tryezën e diskutimit mbi transparencën dhe llogaridhënien në sektorin e shëndetësisë, organizuar nga shoqata “Together for life”.
- 03 Më datë 15.03.2024, Kryetari i KLSH-së, z. Arben Shehu merr pjesë në takimin “IDM Morning Briefing”, organizuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim.
- 04 Më datë 21.05.2024, KLSH merr pjesë në prezantimin e gjetjeve të sondazhit të opinionit publik “Besimi në Qeverisje 2023”, organizuar nga IDM.
- 05 Më datë 05.06.2024, KLSH merr pjesë në tryezën “Ndërlidhja mes opinionit publik dhe politikave: Gjetje dhe perceptime nga Barometri Shqiptar i Sigurisë 2024” organizuar nga Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes (CSDG).
- 06 Më datë 12.06.2024, KLSH merr pjesë në tryezën “Vlerësimi i Sistemit të Vlerësimit të Performancës së Prokurorëve në Shqipëri: Problematika dhe Rekomandime”, zhvilluar nga Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes (CSDG).
- 07 Më datë 25.09.2024, përfaqësues të KLSH-së morën pjesë në takimin e organizuar nga Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes me temë “Vlerësimi i performancës dhe progresit: Një rishikim gjithëpërfshirës i rolit të SPAK dhe Gjykatave Speciale në luftën kundër Korrupsionit dhe Krimit të organizuar (2020-2023)”.
- 08 Më datë 11 qershor 2024, përfaqësues të KLSH, morën pjesë në takimin e konsultimit të hapur (forume ditore) drejtuar nga Ministri për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin dhe Koordinator Kombëtar Kundër Korrupsionit.

**09**

Më datë 25 shtator 2024, KLSH merr pjesë në takimin e organizuar nga Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes me temë: “Vlerësimi i performancës dhe progresit: Një rishikim gjithëpërfshirës i rolit të SPAK dhe Gjykatave Speciale në luftën kundër Korrupsionit dhe Krimit të organizuar (2020-2023)”.

**10**

Më datë 10 dhjetor, 2024 KLSH merr pjesë në ëorkshop - in e organizuar nga ACER dhe ëFD për vlerësimin parandalues të korrupsionit në Projektligjin për Investimet e Huaja direkte në Shqipëri me temë “Vlerësim parandalues për korrupsionin në Projektligjin për Shqyrtimin e Investimeve të Huaja Direkte në Republikën e Shqipërisë”.

**11**

Gjatë vitit 2024, përfaqësues të Drejtorisë Juridike në KLSH, janë angazhuar në cilësinë e ekspertëve pranë Komisionit të Posaçëm "Për Thellimin e Reformave për Mirëqeverisjen, Sundimin e ligjit dhe Antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian" ngritur me Vendimin nr. 50/2024 të Kuvendit të Shqipërisë

**12**

KLSH ka referuar raste me elementë penalë tek organet e drejtësisë. Gjatë vitit 2024, KLSH ka dërguar 13 kallëzime penale, të cilat përfshijnë rastet ku auditimi zbuloi veprime ose mosveprime me shkelje të rënda të ligjit. Përveç kallëzimeve, KLSH ka përcjellë me kërkesë të organeve ligj zbatuese, edhe 35 materiale të tjera informuese për çështje që kërkojnë hetime të mëtejshme.

## 2.3 Forcimi i pavarësisë dhe mandatit të KLSH-së

Pavarësia dhe mandati i KLSH-së janë sanksionuar në Kushtetutë dhe në Ligjin Organik, duke u konsideruar si kusht i domosdoshëm për përmbushjen e misionit dhe arritjen e qëllimeve strategjike.

Për të forcuar pavarësinë dhe mandatin kushtetues, KLSH ka parashikuar të përfundojë rishikimin e ligjit organik, brenda periudhës së këtij plani strategjik. Në vitin 2023, është mbajtur një takim me grupin e punës për të shqyrtuar punën e realizuar. Në vijim, Grupi i punës është rishikuar me Urdhrin e Kryetarit të KLSH - së nr. 97 datë 14.12.2023 duke përfshirë marrjen e asistencës së ekspertëve vendas dhe të huaj dhe sigurimin e një konsultimi interaktiv me këta të fundit për realizimin e draft propozimit me ndryshimet përkatëse të ligjit. Përgjatë vitit 2024, nuk ka patur zhvillime të reja në këtë drejtim.



## 2.4 Hartimi i raporteve të auditimit, të kuptueshme, të qarta dhe relevante për lexuesin

Për të siguruar që raportet e auditimit të kenë impaktin e duhur dhe të transmetojnë në mënyrë të qartë rezultatet e auditimeve të realizuara, gjuha e përdorur duhet të pasqyrojë në mënyrën më të lartë profesionalizmin e institucionit dhe qartësinë gjuhësore. Sipas Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, raportet e auditimit duhet të jenë të qarta dhe të lehta për t'u kuptuar nga të gjithë përdoruesit, duke përfshirë edhe ata që mund të mos kenë njohuri të thelluara mbi auditimet. Duke pasur parasysh që raportet e KLSH kanë audiencë të gjerë, është e nevojshme që audituesi të shprehë gjetjet në një mënyrë të kuptueshme, në mënyrë që të informojë saktë dhe efektivisht mbi funksionimin e institucioneve dhe përdorimin e fondeve publike për përfitimin e qytetarëve. Kjo qartësi e komunikimit është thelbësore për të siguruar besueshmërinë dhe transparencën e procesit të auditimit. Një raport i kuptueshëm ndihmon në përmirësimin e vendimmarrjes dhe garanton përgjegjshmërinë e institucioneve që menaxhojnë burimet publike.

### 1

#### Shkrimi dhe redaktimi i raporteve në KLSH

Me miratimin e Udhëzuesit mbi shkrimin e raporteve të auditimit, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 144, datë 01.08.2023, KLSH ka vijuar të punojë për hartimin e raporteve të auditimit miqësore me lexuesit, me një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme, në mënyrë që të gjenerohen raporte të qarta, të vlefshme dhe të dobishme. Pikërisht, duke pasur parasysh këtë synim, pranë Sektorit të Komunikimit dhe Botimeve është caktuar një punonjës i dedikuar, për qëllime redaktimi të **materialeve të ndryshme që prodhon Kontrolli i Lartë i Shtetit.**



Gjithashtu, gjatë vitit 2024, janë kryer trajnime të vazhdueshme për 187 ditë njerëz, në lidhje me shkrimin e raporteve, të organizuara me burime të brendshme dhe të jashtme.



## 2.5

### Përdorimi i teknikave të të shkruarit profesional që përcjell informacion, gjetje dhe rekomandime në mënyrë të qartë, koncize dhe efektive

#### 1


#### Pranueshmëria dhe zbatueshmëria e rekomandimeve

Gjatë vitit 2024 është kryer verifikimi i zbatimit të rekomandimeve për 97 auditime të evaduar në vitin 2023. Gjithsej janë verifikuar 3937 rekomandime, nga të cilat 2372 masa organizative, 25 përmirësime ligjore, 631 efekte financiare (në numër), 863 masa disiplinore dhe 46 masa administrative.

Nga total 3937 rekomandime të lëna, rezultuan të pranuar 3882, ose rreth 99% dhe papranuar 55 rekomandime ose 1% e tyre.

Në përfundim, 2705 masa ose rreth 70% e masave rezultuan të zbatuara plotësisht, pjesërisht dhe në proces zbatimi.

Konkretisht, nga total 3882 masa të pranuar, 1261 masa rezultuan të jenë zbatuar plotësisht (ose rreth 33% e total masave të pranuar), 578 masa zbatuar pjesërisht (ose rreth 15% e total masave të pranuar), 866 në proces zbatimi (ose rreth 22% e total masave të pranuar); ndërsa 1177 masa janë ende pa zbatuar (ose rreth 30% e total masave të pranuar).



# QËLLIMI 3



## OPTIMIZIMI I KAPACITETEVE PROFESIONALE ME QËLLIM ZOTËRIMIN E NJOHURIVE INOVATIVE NË PUNËN AUDITUESE

Në përputhje me misionin, vizionin dhe Strategjinë Institucionale 2023 - 2027, KLSH vlerëson vazhdimisht efektivitetin dhe përshtatshmërinë e burimeve të nevojshme për të përmbushur mandatin (si institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar në Republikën e Shqipërisë), dhe për të arritur aspiratat institucionale, duke i integruar këto në kulturën organizative të institucionit. Ky qëllim synon, përveç zhvillimit të vazhdueshëm profesional, të krijojë një mjedis pune pozitiv, të qëndrueshëm dhe shpërblyes që nxit rezultate në sfida inovative.

KLSH investon në përmirësimin e aftësive të audituesve, në përdorimin e teknologjisë dhe analizimin e të dhënave (big data), për të kryer auditime më të thelluara të bazuara në sistem. Kjo përfshin komunikimin e rezultateve në forma më të kuptueshme dhe inovative, si dhe rritjen e aftësisë për të reaguar në mënyrë efektive ndaj rrethanave që mund të lindin nga situata emergjente, si ato me të cilat u përballëm në vitet e fundit.

Ky qëllim, përmbushet nëpërmjet tre objektivave të mëposhtme:

**3.1** Zhvillimi dhe ruajtja e ekspertizës në fusha/çështje specifike të auditimit në sektorin publik, me fokus në rritje drejt qasjes dixhitale dhe menaxhimit të të dhënave

**3.2** Krijimi i një ambienti stimulues, sfidues dhe shpërblyes për stafin auditues, për të krijuar një kulturë pozitive të punuarit

**3.3** Maksimizimi i vlerës së shtuar të punës së KLSH-së nëpërmjet implementimit të planit strategjik, duke synuar në vazhdimësi të qenit e një organizate model


# 3.1 Zhvillimi dhe ruajtja e ekspertizës në fusha/çështje specifike të auditimit në sektorin publik, me fokus në rritje drejt qasjes dixhitale dhe menaxhimit të të dhënave

## 1 Trajnimi dhe zhvillimi i punonjësve

Nëpërmjet programit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional, KLSH ka bërë të mundur rritjen e njohurive dhe aftësive që ju nevojiten audituesve në realizimin e objektivave, për rrjedhojë përmirësimin ndjeshëm të cilësisë së punës audituese në funksion të rritjes së transparencës, mirëqeverisjes dhe përdorimit të parasë publike, si dhe rritjes së besimit të publikut dhe palëve të jashtme, tek KLSH.

KLSH ka kryer në mënyrë periodike analizën e nevojave për trajnim (diktuar këto të fundit nga gjithë stafi auditues nëpërmjet pyetësorëve në google form, të cilët dërgohen në fund të vitit), duke zhvilluar trajnime të brendshme si dhe duke ndjekur zhvillimin e trajnimeve nga aktorë të tjerë, me qëllim përmirësimin e njohurive dhe aftësive të stafit të KLSH-së.

Për këtë periudhë u realizuan në total 5441 ditë njerëz trajnimi, nga ku u trajnuan gjithsej 177 auditues, me mesatarisht 26 ditë trajnimi / staf auditues, për periudhën 12 mujore (nga mesatarisht 20 - 25 ditë trajnimi që është objektivi vjetor).



U realizuan trajnime për 41 punonjës, staf jo-auditues, duke realizuar 808 ditë trajnime, ose mesatarisht 20 ditë trajnimi/punonjës, për periudhën 12 mujore, (nga minimumi 14 ditë trajnimi që është objektivi vjetor).

Gjatë këtij viti rreth 40% e trajnimeve u realizuan në sallë, me prezencë fizike, ndërsa 60% e tyre on - line.

Ndër temat kryesore objekt trajnimi gjatë vitit 2024, rendisim: menaxhimi i cilësisë së auditimit; siguria e informacionit dhe krimi kibernetik dhe përmirësimi i aksesit me standarde të larta në shërbimet publike nëpërmjet GovTech; tema mbi çështje të integritetit; auditimi i koncesioneve dhe PPP – ve, siguria kibernetike, trajnime për çështje mjedisore, shkrimin e raporteve, etj.

## 2

### Bashkëpunimi me ECA/GAO dhe homologë për forcim kapacitetesh


KLSH ka vazhduar bashkëpunimin me institucionet homologe me qëllim shkëmbimin e njohurive, nën moton “eksperienca e përbashkët na shërben të gjithëve”.

Referuar Deklaratës së Rios 2022, nxitja e një zëri global më efektiv dhe reagimi ndaj ndryshimit të mjedisit dhe risqeve, kërkon që SAI-t të përmirësojnë mënyrën se si punojnë së bashku dhe të angazhohen me palët e interesuara.

Edhe gjatë vitit 2024 audituesit kanë marrë pjesë vazhdimisht, në aktivitete të ndryshme në kuadër të bashkëpunimit me institucione ndërkombëtare për forcimin e kapaciteteve audituese.



KLSH ka vijuar bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen në programe internship - i dhe fellowship – i me institucionet homologe. Kështu, kanë ndjekur internship - in në Gjykatën Evropiane të Llogarive (ECA) 5 auditues të KLSH – së, dhe ka përfunduar me sukses fellowship - it pranë Zyrës së Auditimit të Qeverisë së SHBA - ve (GAO) 1 auditues. Të 6-të audituesit që kanë ndjekur programet në ECA dhe GAO pasi janë kthyer në KLSH kanë zhvilluar trajnime me qëllim ndarjen e eksperiencës me kolegët.



## 3.2 Krijimi i një ambienti stimulues, sfidues dhe shpërblyes për stafin auditues, për të krijuar një kulturë pozitive të punuari

KLSH, si institucion model i cili udhëheq përmes shembullit, ka fokus të vazhdueshëm zhvillimin e punonjësve, krijimin e një mjedisi stimulues, sfidues e shpërblyes për stafin, me qëllim krijimin e një kulture pozitive të punuari.

Për vitin 2024 numri i punonjësve të miratuar ka qenë 243, i barabartë me numrin e punonjësve në vitin 2023. Në fund të vitit 2024, numri faktik i punonjësve është 216, nga të cilët trupa audituese përbën 75% të numrit total faktik ose 162 auditues.



Me qëllim motivimin dhe shpërblimin e punonjësve, gjatë vitit 2024 në KLSH:

- audituesit kanë ndjekur trajnime brenda dhe jashtë vendit duke zhvilluar njohuritë e tyre në fusha specifike të auditimit të jashtëm publik, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit;
- audituesit janë promovuar nëpërmjet ngritjes në detyrë; si dhe
- nëpërmjet rotacionit në punë, auditues të ndryshëm kanë përfituar njohuri dhe ekspertizë në fusha të ndryshme auditimi, e cila njëkohësisht u ka shërbyer për nxitje dhe zhvillim profesional dhe personal.

### **3.3 Maksimizimi i vlerës së shtuar të punës së KLSH-së nëpërmjet implementimit të planit strategjik, duke synuar në vazhdimësi të qenit e një organizate model**

Duke qenë se Strategjia e Zhvillimit 2023 - 2027 udhëheq Kontrollin e Lartë të Shtetit në aktivitetin e tij institucional në një periudhë pesë vjeçare, është me shumë rëndësi që të monitorohet në vijimësi dhe në mënyrë sistematike për vlerësimin e nivelit të arritjes së objektivave kundrejt parashikimit.

Kështu, plani i veprimit për implementimin e strategjisë, është monitoruar periodikisht nga Departamenti i Metodologjisë, në bashkëpunim me të gjithë departamentet/drejtoritë e tjera, me qëllim vlerësimin e punës së bërë nga KLSH për arritjen e objektivave, identifikimin e problematikave, dhe masat e marra për minimizimin e tyre.



# OBJEKTIVAT E PAREALIZUARA DHE NË PROCES

## 1 Objektiva të porealizuara

Referuar Planit strategjik të KLSH, 2023-2027, ku 3 qëllimet strategjike janë detajuar në 11 objektiva, 30 nën-objektiva dhe këto të fundit në 60 tregues performance, rezultoi se për vitin 2024 janë realizuar:

- 3 nga 60 tregues performance i përkasin aktiviteteve të përfunduara në vitin 2023\*;
- janë realizuar në total 54 tregues nga 57, ose 95 % e tyre
- nuk janë realizuar 3 nga 57 tregues të matur për vitin 2024, ose 5 % e tyre;

Treguesit e porealizuar ende janë:

1. Përgatitja e Udhëzuesit për Zbatimin e Buxhetit;
2. Pilotimi i Udhëzuesit për Zbatimin e Buxhetit; si dhe
3. Ri - ngritja e grupit për hartimin e propozimeve për ndryshime në ligjin për KLSH nr. 154/2014, duke përfshirë ekspertë të fushës si dhe ekspertizë të organizatave si SIGMA, IDI, SAI i Norvegjisë, etj partnerë ndërkombëtarë, afati i zbatimit të të cilit përkon me afatin e përfundimit të këtij Plani Strategjik.

---

Treguesit e performancës të cilët kanë rezultuar të realizuar për vitin 2024 janë: Hartimi i Udhëzuesit për "Të shkruarin e Raporteve"; Rishikimi i formatit të Raportit të Auditimit në përputhje me Udhëzuesin e "Të shkruarit të Raportit" dhe praktikave më të mira; dhe Ri konceptimi i Buletinit Statistikor

# ANEKSE

## Aneks 1: Objektivat e realizuara për vitin 2024

Qëllimi 1: Rritja dhe përmirësimi i rolit të KLSH si mbështetës i Kuvendit për llogaridhënie efektive dhe shqyrtim të kujdesshëm e të thelluar të enteve përdoruese të fondeve	19
Aktiviteteve të përbashkëta me SAI-et homologe dhe INTOSAI, për çështje që lidhen me: -auditimet në fushën e mjedisit; -auditime mbi barazinë gjinore; -IT tools; -zhvillimin e metodologjive për auditime në kohë reale	1
Auditimet që përzgjidhen bazuar në Udhëzuesin e Riskut (në nr ose %)	1
Numri i aktiviteteve të përbashkëta me Kuvendin, me qëllim rritjen e shkallës së zbatimit të rekomandimeve	1
Analiza e rezultateve nëpërmjet kryerjes së analizave vjetore	1
Azhornim i manualeve dhe udhëzuesve në koherencë me ndryshimet e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit të rishikuara	1
Dizenjimi i aplikacioneve në funksion të menaxhimit të proceseve dhe të dhenave, në mënyrë të automatizuar	1
Fushat e reja sipas OZHQ-ve	1
Hartimi i planit vjetor të auditimeve mbështetur në zhvillimet makro-ekonomike në financat publike (fushat me risk)	1
Monitorim i vazhdueshëm me qëllim ndryshimin e planit për të reflektuar dinamikat makroekonomike dhe prioritetet, në planin e auditimeve, sipas nevojës.	1
Nr i auditimeve që mbulojnë fushat e rekomanduara nga Axhenda për Zhvillim të Qëndrueshëm 2030 (OZHQ)	1
Nr i fushave të audituara në bazë sistemi	1
Numri i dëgjësave të zhvilluara në Kuvend dhe në Komisionin e Ekonomisë dhe komisione të tjera parlamentare, për çështjet me interes të veçantë të trajtuara në auditime	1
Numri i raporteve të auditimit të përcjella në Kuvend	1
Numri i raporteve të auditimit të përcjella në Ministrinë e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin	1
Periodiciteti i rishikimit të Udhëzuesit të Fushave me Risk, dhe shndërrimi i tij në Metodologji në përfundim të periudhës 5 vjeçare	1
Plotësimi dhe përditësimi periodik i Platformës Ndërinstitucionale Online të Kuvendit mbi zbatimin e rekomandimeve nga subjektet e audituara	1
Riorganizimi i statistikave në funksion edhe të zbatimit të rekomandimeve si dhe hartimi i një moduli të veçantë për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve, në Sistemin e Menaxhimit të Auditimeve.	1
Zhvillimi i moduleve të IT, nëpërmjet zhvillimit të strukturës IT si dhe në kuadër të marrëdhënieve ekzistuese të bashkepunimit me SAI-e homologe, në këtë drejtim	1
Zhvillimi i trajnimeve dhe përgatitja e informacionit nëpërmjet doracakeve/udhëzuesve/broshurave, etj.	1

<b>Qëllimi 2:</b> Rritja e impaktit të punës audituese në qeverisjen e mirë nëpërmjet përmirësimit të nivelit të zbatimit të rekomandimeve	25
Numri i kronikave që jepen në median vizive lidhur me raportet e auditimit.	1
Përqindja e rekomandimeve të zbatuara nga subjektet e audituara, në nivel auditimi / audituesi / departamenti	1
Analizë nga Drejtoria e Kontrollit të Cilësisë & Zbatimit të Standardeve me qëllim krijimin e disa indikatorëve për të vlerësuar rekomandimet	1
Investime në aplikacione të përdorshme nga audituesit me qëllim aplikimin e infografikëve edhe në raporte auditimi	1
Klikimet e faqes zyrtare të KLSH-së	1
Komunikimi për shtyp i rezultateve 4 mujore	1
Krijimi i një hapësire të dedikuar për anketime	1
Ngritja e një njësie të dedikuar për redaktimin e raporteve (ose punonjësi i dedikuar për redaktimin) dhe dokumentave të auditimit	1
Nr i broshurave të përgatitura mbi rezultatet e auditimeve me ndjeshmeri të larte	1
Nr i ekspertëve të jashtëm të angazhuar në auditime, me ekspertizë në fusha të vecanta si në atë të hidrokarbureve, OZHQ-ve, teknologjinë e informacionit, etj.	1
Nr. i auditimeve për të cilat është bashkëpunuar me SPAK dhe organe të tjera	1
Numri i aktiviteteve të bashkëpunimit dhe tryezave të rrumbullakëta me organet e linjës së parë në luftën kundër korrupsionit.	1
Numri i artikujve dhe kronikave që publikohen në median e shkruar ose jepen në median audiovizive lidhur me rezultatet e auditimeve të KLSH	1
Numri i raporteve të auditimit që i dërgohen aktorëve kryesorë	1
Numri i trajnimeve të kryera mbi metodat e shkrimit të raporteve	1
Numri total i ankesave dhe kërkesave për informacion	1
Organizimi i aktiviteteve të ndryshme, me përfaqësues të shoqërisë civile	1
Pasurimi i faqes zyrtare me opsionin e gjuhës angleze	1
Përgatitja e "Fakte & figura" për web	1
Përqindja e rekomandimeve të pranuar nga subjektet e audituara, në nivel auditimi / audituesi / departamenti	1
Promovimi i faqes web nëpërmjet statistikave që shndërrohen në lajm	1
Rritja e pranisë në media sociale për të rritur më tej aksesueshmërinë e palëve të interesuara	1
Shoqërimi i raporteve të auditimit të performancës me broshura mbi rezultatet e auditimit	1
Standartizimi i dokumenteve bazë dhe metodave inovative për përpunimin e tyre	1
Vijimi i raportimit në kuadër të Strategjisë Ndërsektoriale Antikorrupsion	1
<b>Qëllimi 3:</b> Optimizimi i kapaciteteve profesionale me qëllim zotërimin e njohurive inovative në punën audituese	10
Data Base për vlerësimin e performancës & hartimi i planeve personale;	1
Data bazë me informacione për zhvillimet profesionale dhe akademike të çdo audituesi.	1
Ngritja e grupeve të punës për ndjekjen e Strategjisë. Hartimi i planit të monitorimit të Strategjisë	1
Niveli i qarkullimit brenda institucionit;	1
Numri i audituesve që kryejnë internship në ECA, GAO apo institucione të tjera me SAI-e homologe	1
Numri i audituesve të ngritur në detyrë	1
Numri i audituesve të rekrutuar sipas fushës kundrejt numrit total të audituesve	1
Numri i ditëve të trajnimit për çdo auditues	1
Numri i temave të auditimit të propozuara nga audituesit e trajnuar jashtë, të cilët sjellin praktika të mira	1
Përqindja e audituesve të trajnuar jashtë, që bëjnë trajnime për kolegët për të ndarë njohuritë e marra	1
<b>Grand Total</b>	<b>54</b>

## Aneks 2: Aktivitetet e parealizuara për vitin 2024

QËLLIMI/AKTIVITETET	KPI
<b>Qëllimi 1:</b> Rritja dhe përmirësimi i rolit të KLSH si mbështetës i Kuvendit për llogaridhënie efektive dhe shqyrtim të kujdesshëm e të thelluar të enteve përdoruese të fondeve	
Përgatitja e Udhëzuesit për Zbatimin e Buxhetit	1.2.2
Pilotimi i Udhëzuesit për Zbatimin e Buxhetit	1.2.2
<b>Qëllimi 2 :</b> Rritja e impaktit të punës audituese në qeverisjen e mirë nëpërmjet përmirësimit të nivelit të zbatimit të rekomandimeve	
Ri ngritja e grupit për hartimin e propozimeve për ndryshime në ligjin për KLSH nr. 154/2014, duke përfshirë ekspertë të fushës si dhe ekspertizë të organizatave si SIGMA, IDI, SAI i Norvegjisë, etj partnerë ndërkombëtarë.	2.3.2



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Të dhënat mbi realizimin e objektivave të strategjisë, janë raportuar nga departamentet e auditimit dhe strukturat e tjera përgjegjëse për realizimin e objektivave, dhe janë mbledhur dhe përpunuar nga Departamenti i Metodologjisë, Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit Profesional.

Raporti i monitorimit është përgatitur nga Departamenti i Metodologjisë, Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit Profesional

Ky raport përfshin linqe ndërvepruese që mbështesin përmbajtjen. Për të aksesuar këtë funksion, ju lutemi shikoni versionin dixhital të këtij raporti në [www.klsh.org.al](http://www.klsh.org.al).



Rruga "Abdi  
Toptani" Nr.1 Tiranë



[klsh.org.al](http://klsh.org.al)



+355 4 2247294



[klsh@klsh.org.al](mailto:klsh@klsh.org.al)